



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. \_\_, datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2026

**PËR PROCEDURAT E REFERIMIT DHE MENAXHIMIT TË RASTEVE TË FËMIJËVE NË NEVOJË PËR KUJDES ALTERNATIV NË FAMILJE DHE KRITERET, PROCEDURAT DHE INSTRUMENTET PËR VLERËSIMIN VLERËSIMIN PERIODIK TË SITUATËS SË FËMIJËS SË VENDOSUR NË KUJDES ALTERNATIV NË FAMILJE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14, pika 3 dhe nenit 22, pika 5 të ligjit nr. Nr. 92/2025, “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet sociale, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e procedurave të referimit dhe të menaxhimit të rasteve dhe vlerësimin periodik të situatës së fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje, sipas tekstit dhe Shtojcave që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen mekanizmat këshillimorë e koordinues institucionalë dhe strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror e vendor, sipas nenit 14, pika 3, nenit 22, pika 5 të Ligjit nr.92/2025 “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

## **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i këtij vendimi është të garantojë një proces të koordinuar, të standardizuar dhe të bazuar në interesin më të lartë të fëmijës, kur fëmija është në nevojë për mbrojtje dhe/ose i propozohet apo vendoset në kujdes alternativ në familje.

### **Neni 2 Objekti**

Ky vendim rregullon procedurat dhe mekanizmat për identifikimin, referimin, vlerësimin, menaxhimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe/ose kujdes alternativ në familje. Ai përcakton rolet dhe përgjegjësitë e strukturave kompetente në nivel vendor dhe qendror, si dhe mënyrën e koordinimit ndërinstitucional për garantimin e mbrojtjes, kujdesit dhe vlerësimit periodik të situatës së fëmijës, në përputhje me interesin më të lartë të tij/saj.

### **Neni 3 Fusha e zbatimit**

1. Ky vendim zbatohet për të gjitha rastet kur:
  - a) fëmija raportohet/identifikohet si në nevojë për mbrojtje dhe nga vlerësimi rezulton nevoja për masë mbrojtjeje që përfshin kujdes alternativ në familje;
  - b) fëmija është vendosur në kujdes alternativ në familje (vullnetar ose profesional) dhe i nënshtrohet vlerësimit periodik.
2. Ky vendim zbatohet nga njësitë/punonjësit e mbrojtjes së fëmijës në bashki (NJMF/PMF), njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit (NJVNR), strukturat e shërbimeve shoqërore në bashki, si dhe institucionet e tjera pjesëmarrëse.

## **KREU II ORGANIZIMI DHE PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE**

### **Neni 4 Autoriteti përgjegjës dhe rolet**

1. Njësia e mbrojtjes së fëmijës (NJMF/PMF), njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit në bashki (NJVNR) në nivel vendor, struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki, Grupi Teknik Ndërsektorial (GTN), komisioni multidisiplinar për kujdesin alternativ në bashki, Shërbimi Social Shtetëror dhe strukturat e tij rajonale, si dhe

institucionet publike dhe jo-publike janë autoritet përgjegjës që, sipas kompetencave, kontribuojnë në vlerësimin, vendosjen dhe mbështetjen e fëmijës dhe familjes gjatë periudhës së kujdesit alternativ në familje.

2. Njësia/punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve, në cilësinë e menaxherit të rastit, është përgjegjës për:
  - a) marrjen në shqyrtim të rasteve të identifikuara, referuara ose raportuara për situata të rrezikut, neglizhimit, abuzimit, mungesës së kujdesit prindëror ose rrethana të tjera që kërkojnë vlerësim për masa mbrojtjeje dhe/ose vendosje në kujdes alternativ në familje,
  - b) kryerjen e vlerësimit fillestar dhe të plotë,
  - c) hapjen dhe administrimin e dosjes së rastit,
  - d) hartimin dhe koordinimin e zbatimit të Planit Individual të Mbrojtjes (PIM),
  - e) thirrjen dhe bashkërendimin e punës së ekipit shumëdisiplinar/GTN,
  - f) monitorimin e situatës së fëmijës në familjen kujdestare nëpërmjet vizitave dhe takimeve,
  - g) dokumentimin e ecurisë së fëmijës në familjen kujdestare,
  - h) dokumentimin e marrëdhënies dhe nivelit të atashimit të fëmijës me familjen biologjike/aktuale, ndjekjen e procesit të riintegritimit familjar kur është në interesin më të lartë të fëmijës, si dhe referimin dhe ndjekjen e procedurave për birësim ose forma të tjera të përhershme kujdesi, në rastet kur riintegrimi familjar nuk është i mundur;
  - i) hartimin dhe koordinimin e zbatimit të Planit Individual të Kujdesit (PIK),
  - j) rishikimin e Planit Individual të Kujdesit,
  - k) propozimin e transferimit ose mbylljes së rastit, sipas procedurave të këtij vendimi,
  - l) njoftimin dhe referimin pranë Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe strukturave hierarkike përgjegjëse në nivel vendor, në rastet e moszbatimit të Planit Individual të Kujdesit, mosbashkëpunimit institucional ose shkeljeve që çenojnë mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijës, me qëllim marrjen e masave administrative dhe institucionale sipas legjislacionit në fuqi.
3. NJVNR në bashki:
  - a) bashkëpunon me menaxherin e rastit për vlerësimin e nevojave, identifikimin dhe aksesimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, referimin pranë ofruesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, vlerësimin periodik të situatës së fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje dhe hartimin dhe zbatimin e PIK,
  - b) kontribuon në planifikimin e ndërhyrjeve të nevojshme, ndjekjen e realizimit të shërbimeve dhe dokumentimin e të dhënave të nevojshme për qëllime monitorimi dhe planifikimi.
4. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki, nëpërmjet drejtuesit përkatës:
  - a) siguron funksionimin e mekanizmave vendore të mbrojtjes së fëmijës dhe të shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen,
  - b) miraton dhe rishikon planin individual të mbrojtjes sipas legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe planin individual të kujdesit sipas ligjit për kujdesin alternativ në familje,

- c) garanton koordinimin ndërsektorial në territor,
  - d) ndërmerr masa administrative për sigurimin e shërbimeve dhe burimeve të nevojshme,
  - e) mbikëqyr zbatimin e këtij vendimi nga strukturat vartëse
  - f) miraton mbylljen e rastit sipas propozimit të njësisë/punonjësit të mbrojtjes së fëmijëve dhe GTN.
5. Shërbimi Social Shtetëror dhe strukturat e tij rajonale ushtrojnë rol mbështetës, monitorues dhe koordinues në zbatimin e këtij vendimi, përfshirë:
- a) mbledhjen dhe konsolidimin e të dhënave,
  - b) analizën e nevojave,
  - c) orientimin metodologjik,
  - d) mbështetjen e ngritjes së kapaciteteve,
  - e) bashkëpunimin me njësitë vendore dhe strukturat qendrore për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe të mekanizmave të mbrojtjes.
6. Institucionet e tjera publike dhe jopublike, përfshirë arsimin, shëndetësinë, policinë, ofruesit e shërbimeve dhe organizatat kontribuese:
- a) bashkëpunojnë në përputhje me kompetencat e tyre,
  - b) referojnë rastet,
  - c) marrin pjesë në proceset e vlerësimit dhe planifikimit kur thirren,
  - d) ofrojnë shërbimet e përcaktuara në Planin Individual të Kujdesit,
  - e) raportojnë për realizimin e aktiviteteve dhe shërbimeve të dakordësuar PIM/PIK,
  - f) respektojnë rregullat e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

## **Neni 5**

### **Mekanizmi ndërinstytucional dhe koordinues**

1. Mekanizmat ndërinstytucionalë dhe koordinues për menaxhimin e rasteve të fëmijëve të vendosur në kujdes alternativ në familje bashkërendojnë për të garantuar vendimmarrje të koordinuar, zbatim efektiv të PIM dhe PIK dhe mbrojtje të vazhdueshme të fëmijës. Mekanizmat ndërinstytucionalë dhe koordinues për menaxhimin e rasteve të fëmijëve të vendosur në kujdes alternativ janë:
  - a) Grupi Teknik Ndërsektorial (GTN) për menaxhimin e rasteve,
  - b) Komisioni Multidisiplinar për kujdesin alternativ në familje, i ngritur në nivel bashkie,
  - c) Komisioni për shqyrtimin e Ankesave.
2. Grupi Teknik Ndërsektorial (GTN) është mekanizmi kryesor ndërinstytucional për vlerësimin e rastit, koordinimin e ndërhyrjeve dhe ndjekjen e zbatimit të Planit Individual të Kujdesit. GTN mblidhet me thirrjen e punonjësit për mbrojtjen e fëmijës dhe, sipas rastit, në mënyrë të jashtëzakonshme kur niveli i rrezikut e kërkon. Institucionet pjesëmarrëse të GTN janë të detyruara të kontribuojnë me informacion dhe të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për rregullat e funksionimit të grupit

teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive dhe njërive administrative. GTN kryen detyrat si vijon:

- a) shqyrton vlerësimet e rastit dhe nevojat e fëmijës;
  - b) jep rekomandime për masat e mbrojtjes dhe përgatitjen e fëmijës për vendosje;
  - c) përcakton detyrat, afatet dhe përgjegjësitë e institucioneve pjesëmarrëse;
  - d) ndjek dhe raporton për zbatimin dhe rishikimin e PIK.
3. Komisioni Multidisiplinar për kujdesin alternativ në familje është organi kolegjal vendimmarrës për përzgjedhjen e fëmijës dhe të familjes kujdestare, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ushtron funksionet e mëposhtme:
- a) vendos për përshtatshmërinë e vendosjes së fëmijës në kujdes alternativ në familje;
  - b) vendos për përputhshmërinë ndërmjet nevojave të fëmijës dhe kapaciteteve të familjes kujdestare;
  - c) merr vendim për përzgjedhjen dhe vendosjen e fëmijës në familjen kujdestare;
  - d) shqyrton rastin për rishikim të vendosjes kur ndryshojnë rrethanat.
4. Bashkërendimi ndërmjet GTN-së dhe Komisionit Multidisiplinar realizohet përmes:
- a) shkëmbimit të dokumentacionit dhe vlerësimeve të rastit;
  - b) reflektimit të vendimeve të Komisionit në Planin Individual dhe në ndërhyrjet e planifikuara nga GTN;
  - c) përditësimit të vazhdueshëm të Planit Individual nga profesionisti përgjegjës për menaxhimin e rastit, në përputhje me vendimmarrjen dhe zhvillimet e rastit.
5. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore, në përputhje me legjislacionin në fuqi:
- a) siguron mbështetjen administrative dhe institucionale për ndjekjen e procedurës së paraqitjes së kërkesës në gjykatë nga njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, për vlefshmërinë e vendosjes së fëmijës në kujdes alternativ në familje, në përputhje me legjislacionin në fuqi, brenda 5 ditëve të punës;
  - b) siguron që vendimi dhe masat e përcaktuara të reflektohen në Planin Individual (PIM dhe PIK);
  - c) bashkëpunon me GTN-në dhe aktorët e tjerë për ndjekjen e zbatimit të vendimit dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme për fëmijën dhe familjen kujdestare.

## **Neni 6**

### **Roli i Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen**

1. Shërbimet mbështetëse për fëmijën dhe familjen përfshihen në menaxhimin e rasteve të fëmijëve të vendosur në kujdes alternativ në familje, në përputhje me Planin Individual të Mbrojtjes dhe Planin Individual të Kujdesit Alternativ dhe me vendimmarrjet e mekanizmave koordinues. Shërbimet mbështetëse për fëmijën dhe familjen bashkëpunojnë ngushtë me njësinë/punonjësin e mbrojtjes së fëmijës dhe me njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit, merr pjesë në mbledhjet e Grupit Teknik Ndërsektorial dhe sipas rastit, në proceset e Komisionit Multidisiplinar për kujdesin alternativ, me qëllim

planifikimin, ofrimin dhe vijimin e shërbimeve mbështetëse për fëmijën, familjen kujdestare dhe, kur është e përshtatshme, familjen biologjike/aktuale.

2. Në kuadër të zbatimit të Planit Individual të Mbrojtjes dhe Planin Individual të Kujdesit Alternativ, Shërbimet mbështetëse për fëmijën dhe familjen sigurojnë ofrimin e shërbimeve psiko-sociale dhe ndërhyrjeve në komunitet për fëmijët në kujdes alternativ në familje, përfshirë këshillimin, ndjekjen e rregullt, mbështetjen për përfshirjen arsimore dhe sociale, si dhe koordinimin me shërbimet shëndetësore dhe arsimore. Për garantimin e ndërhyrjeve të vazhdueshme dhe në kohë, Shërbimet mbështetëse për fëmijën dhe familjen organizojnë shërbim lëvizës dhe mundëson funksionimin e një ekipi të dedikuar për kujdesin alternativ, i cili kryen ndërhyrje në terren, mbështet familjen kujdestare në menaxhimin e vështirësive që lidhen me përshtatjen dhe mirëqenien e fëmijës, si dhe raporton periodikisht te menaxheri i rastit për ecurinë dhe rezultatet e ndërhyrjeve.
3. Shërbimet mbështetëse për fëmijën dhe familjen mbështesin procesin e ribashkimit të fëmijës me familjen biologjike/aktuale, kur kjo është e vlerësuar si zgjidhje e sigurt dhe në interesin më të lartë të fëmijës, duke ofruar ndërhyrje për forcimin e kapaciteteve prindërore, përgatitjen e fëmijës dhe familjes për tranzicionin, si dhe ndjekje pas ribashkimit, në përputhje me Planin Individual. Në ushtrimin e funksioneve të veta, Shërbimet mbështetëse për fëmijën dhe familjen dokumentojnë ndërhyrjet dhe rezultatet e tyre në përputhje me formatet standarde dhe kontribuojnë në rishikimin e Planit Individual, sipas procedurave të këtij vendimi.

### **KREU III**

#### **PROCEDURA E MENAXHIMIT TË RASTIT**

##### **Neni 7**

##### **Hapat e menaxhimit të rastit**

1. Menaxhimi i rastit përfshin këto hapa:

- a) Identifikimi;
- b) Raportimi;
- c) Vlerësimi fillestar;
- d) Hapja e dosjes dhe caktimi i menaxherit të rastit;
- e) Vendimmarrja për masat e mbrojtjes dhe kujdesin alternativ në familje;
- f) Vlerësimi i plotë;
- g) Hartimi i Planit Individual, i cili përfshin dhe riintegrim në familjen biologjike;
- h) Zbatimi/monitorimi/rishikimi;
- i) Vlerësimi periodik (për fëmijën e vendosur, familjen kujdestare dhe familjen biologjike);
- j) Transferimi kur vlerësohet i nevojshëm;
- k) Mbyllja e rastit.

## **Neni 8**

### **Identifikimi**

1. Identifikimi i fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe/ose fëmijës pa kujdes prindëror, në kuptim të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për kujdesin alternativ në familje dhe për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, realizohet nëpërmjet sinjalizimit, referimit ose konstatimit nga çdo subjekt publik ose privat, si dhe nga vetë fëmija, familjarët apo anëtarët e komunitetit.
2. Njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit në nivel vendor kanë detyrimin të kryejnë identifikim proaktiv të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, në përputhje me funksionet e tyre ligjore, nëpërmjet:
  - a) verifikimit të çdo informacioni ose sinjalizimi të marrë;
  - b) monitorimit të situatave me risk në komunitet;
  - c) evidentimit të rasteve përmes burimeve të hapura të informacionit, përfshirë median dhe mjetet e komunikimit publik.
3. Identifikimi i fëmijës shërben si faza fillestare e procesit të menaxhimit të rastit dhe pasohet nga vlerësimi i nevojave dhe ndërmarrja e masave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **Neni 9**

### **Raportimi**

1. Pas identifikimit ose dyshimit të arsyeshëm se një fëmijë është në nevojë për mbrojtje, jashtë kujdesit prindëror ose në rrezik për ta humbur atë, çdo person fizik ose juridik, si dhe çdo punonjës i institucioneve publike apo jo-publike, i cili vihet në kontakt me fëmijën për shkak të detyrës, profesionit, veprimtarisë ose ofrimit të shërbimit, ka detyrimin të raportojë menjëherë rastin pranë strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës dhe/ose organeve të Policisë së Shtetit, sipas natyrës dhe urgjencës së rastit. Ky detyrim përfshin, në veçanti, punonjësit e institucioneve arsimore, shëndetësore, të përkujdesjes shoqërore, shërbimeve psikosociale, maternitetet në rastet e braktisjes së fëmijës në lindje, strukturat ofruese të shërbimeve sociale publike dhe jopublike, si dhe çdo strukturë tjetër vendore që identifikon ose vihet në dijeni për situatën e fëmijës.
2. Kur identifikimi bëhet nga punonjës të një institucioni publik ose jo-publik, raportimi pranë strukturave përgjegjëse nuk përjashton detyrimin për njoftimin e menjëhershëm të drejtuesit të institucionit, sipas rregullave të brendshme të raportimit dhe përgjegjësisë institucionale.
3. Raportimi i fëmijës në nevojë për mbrojtje bëhet me çdo mjet komunikimi, me telefon, e-mail, me postë, në formë shkresore, duke kontaktuar punonjësën e strukturave të Policisë së Shtetit apo të strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës.
4. Profesionistët e përmendur në pikat 1 e 2 të këtij neni, ose struktura përgjegjëse pranë institucionit/ve raportojnë menjëherë, rastet që identifikohen si në rrezik të menjëhershëm

apo të lartë për të humbur kujdesin prindëror, por jo më vonë se 24 orë nga momenti i identifikimit. Raportimi bëhet nëpërmjet formularit të raportimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, që përdoret gjatë procedurave të referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes në zbatim të ligjit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

5. Formulari i plotësuar dërgohet në mënyrë elektronike dhe me postë te njësia/punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve. Në formular hidhet i gjithë informacioni dhe të gjitha detajet e ditura nga personi/personat që janë në dijeni dhe kanë raportuar rastin.
6. Rasti raportohet te PMF-ja përgjegjëse për territorin ku është bërë identifikimi. Në rast se është e pamundur të kontaktohen këto struktura, njoftohet Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, e cila merr masa për referimin e rastit pranë strukturave vendore të mbrojtjes, ku është identifikuar rasti.
7. Me marrjen e raportimit, njësia/punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve ka detyrimin të ndërmarrë të gjitha masat e veprimet e nevojshme për verifikimin e informacionit të dhënë dhe fillimin e vlerësimit fillestar të rastit.

## **Neni 10**

### **Vlerësimi fillestar**

1. Vlerësimi fillestar është një vlerësim i nivelit të rrezikut, bazuar në informacionin e disponueshëm nga identifikimi ose raportimi, si dhe nga informacioni që mund të merret nga institucionet, organizatat apo persona të tjerë, që kanë dijeni për rastin dhe/ose janë në kontakt me vetë fëmijën.
2. Vlerësimi fillestar kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur, brenda 24 orëve dhe, maksimalisht, brenda 48 orëve pas raportimit, me qëllim vlerësimin e shpejtë të rrezikut dhe nevojave emergjente.
3. PMF-ja gjatë vlerësimit fillestar, vlerëson:
  - a) Nivelin e rrezikut për një periudhë afatshkurtër, duke mbajtur në konsideratë sigurinë, mbrojtjen fizike, shëndetin e fëmijës dhe nevojën për masë emergjente të mbrojtjes;
  - b) Nevojat bazë, për sa u përket ushqimit, higjienës, strehimit dhe kujdesit shëndetësor e psikologjik;
  - c) Shërbimet e domosdoshme, me qëllim përmbushjen e nevojave të identifikuara në kushtet e emergjencës.
4. Vlerësimi fillestar bëhet nga njësia/punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve në bashkëpunim me strukturat e kujdesit alternativ në njësinë vendore, në territorin ku gjendet fëmija. Pas intervistimit fillestar të fëmijës apo verifikimit të gjendjes së tij, nëse fëmija nuk është në gjendje të flasë apo të intervistohet, të dhënat e marra nga PMF-ja dokumentohen menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 24 orë, në vlerësimin fillestar sipas formularit të vlerësimit fillestar që përdoret gjatë procedurave të referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për

zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes në zbatim të ligjit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

5. Nëse, pas vlerësimit fillestar, PMF-ja vlerëson se fëmija është në rrezik për të humbur kujdesin prindëror, duhet të largohet nga mjedisi familjar ose ndodhet në kujdes joformal, ajo:
  - a) siguron masat emergjente të mbrojtjes dhe shërbimet e nevojshme për fëmijën;
  - b) hap dhe administron dosjen e rastit në format fizik dhe elektronik;
  - c) dokumenton të dhënat dhe veprimet e kryera sipas procedurave të menaxhimit të rastit dhe legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
6. Gjeneralitetet e fëmijës kodohen me një numër identifikues, i cili do të jetë numri identifikues për fëmijën gjatë gjithë procesit të menaxhimit si dhe për dokumentimin në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ. Ky numër do të përdoret gjatë të gjitha komunikimeve, përveç rastit kur është e nevojshme të përdoret emri i fëmijës, për efekt të referimit apo ndërhyrjeve për mbrojtjen e tij.
7. Gjatë vlerësimit fillestar dhe intervistimit të fëmijës, në rastet e fëmijëve me aftësi të kufizuara, ose të fëmijëve që nuk flasin gjuhën shqipe përdoren metoda dhe forma komunikimi të përshtatura sipas nevojave të tyre, duke përfshirë mjete alternative komunikimi, mbështetje nga profesionistë të specializuar dhe përshtatje të mjedisit të intervistës dhe, kur është e nevojshme, sigurimin e përkthyesit ose ndërmjetësit gjuhësor.
8. Drejtuesi i strukturës së shërbimeve shoqërore / strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore / NJMF-së cakton një nga PMF-të e kësaj njësie si menaxher rasti për secilin fëmijë të identifikuar në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë përkatëse. Drejtuesi i strukturës së shërbimeve shoqërore, përcakton një PMF si menaxher rasti, i cili në bashkëpunim me punonjësin e NJVNR/punonjësin për shërbimet e kujdesit alternativ në njësi, do të koordinojnë dhe realizojnë vlerësimin e situatës së fëmijës.

## **Neni 11**

### **Vlerësimi i plotë**

1. Vlerësimi i plotë kryhet për çdo rast të fëmijës në nevojë për mbrojtje dhe ka si qëllim të përcaktojë në mënyrë të plotë e të thelluar nivelin e rrezikut, në të cilin ndodhet fëmija, si dhe të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm për hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes dhe Planit Individual të Kujdesit Alternativ.
2. PMF-ja, gjatë vlerësimit të plotë, vlerëson:
  - a) Nivelin e rrezikut në të cilin ndodhet fëmija në periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, si dhe faktorët e rrezikut për të humbur kujdesin prindëror;
  - b) Nevojat e fëmijës në përputhje me moshën dhe zhvillimin e tij/saj, nevojat e familjes biologjike/aktuale, si dhe kapacitetet prindërore dhe mundësitë për ruajtjen ose rikthimin e kujdesit prindëror;
  - c) Faktorët që kanë çuar në cënimin e kujdesit prindëror, gatishmërinë e familjes biologjike/aktuale për bashkëpunim, si dhe nevojat për ndërhyrje dhe shërbime

mbështetëse me qëllim parandalimin e ndarjes ose riintegrimin e fëmijës në familje, kur kjo është në interesin më të lartë të fëmijës;

- ç) Në rastet kur për fëmijën është marrë një masë emergjente mbrojtjeje, përfshirë edhe rastet e fëmijëve viktimë të dhunës në familje të moshës 16-18 vjeç të pajisur me urdhër mbrojtjeje, vlerësimi i plotë përfshin verifikimin e situatës së fëmijës pas marrjes së masës, rezultatit e procedurës gjyqësore për konfirmimin e saj, si dhe vlerësimin e kushteve dhe përshtatshmërisë së personit ose familjes pranë së cilës është vendosur fëmija.
3. Për realizimin e vlerësimit të plotë, PMF-ja duhet të kryejë, të paktën:
    - a) një vizitë në shtëpinë e fëmijës dhe të dhënat/informacionin e marrë gjatë vizitës dokumentohen në formularin standard të vizitës dhe vëzhgimit në familje, sipas instrumenteve të miratuara për referimin, menaxhimin e rastit dhe vlerësimin e nevojave të fëmijës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
    - b) Një intervistë me fëmijën, motrat/vëllezërit dhe anëtarët e tjerë të familjes, ose personat që kujdesen për fëmijën, duke vlerësuar marrëdhëniet familjare, kapacitetet prindërore dhe gatishmërinë për bashkëpunim në procesin e mbrojtjes dhe riintegrimin të fëmijës. Të dhënat dokumentohen në formularin standard të intervistës, sipas procedurave të referimit dhe menaxhimit të rastit në fuqi.
  4. Për realizimin e vizitave në familje, në rastet kur është e nevojshme për arsye sigurie apo kur prindi nuk është bashkëpunues dhe nuk lejon vizitën apo takimin e PMF-së me fëmijën/fëmijët e tjerë të familjes, PMF-ja kërkon që gjatë kryerjes së vizitës në familje të shoqërohet nga strukturat e Policisë së Shtetit.
  5. Pas mbledhjes së informacioneve për rastin, PMF-ja plotëson formularin e vlerësimit të thelluar dhe analizën e rrezikut, sipas formularit të vlerësimit dhe analizës së riskut të përdorur gjatë procedurave të referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes në zbatim të ligjit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
  6. Vlerësimi i plotë kryhet brenda 20 ditëve pune nga vlerësimi fillestar. Gjatë kësaj periudhe PMF-ja ka detyrimin të mbledhë GTN-në, në rastet kur fëmija në nevojë për mbrojtje është në nivel rreziku të mesëm dhe të lartë.
  7. Vlerësimi i plotë për rastet e rrezikut të menjëhershëm kryhet nga PMF-ja brenda 5 ditëve pune, nga miratimi i masës emergjente të mbrojtjes nga drejtori i sektorit/drejtorisë së shërbimeve shoqërore në bashki. Vendimi për masën e mbrojtjes dhe vlerësimi i plotë i kalojnë për miratim gjykatës.

## Neni 12

### Plani Individual i Mbrojtjes dhe koordinimi i shërbimeve

1. Pas plotësimit të formularit të vlerësimit dhe analizës së rrezikut, PMF-ja harton Planin Individual të Mbrojtjes (PIM), në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e fëmijës

dhe formularët standardë të menaxhimit të rastit. PIM përcakton ndërhyrjet, masat dhe shërbimet për fëmijën, familjen biologjike/aktuale dhe, sipas rastit, familjen kujdestare. Në procesin e hartimit të PIM-it përfshihet edhe fëmija, në përputhje me moshën, nivelin e zhvillimit dhe aftësinë për të kuptuar.

2. Çdo institucion, autoritet ose ofrues shërbimi i përcaktuar në Planin Individual të Mbrojtjes (PIM) ka detyrimin të realizojë veprimet, ndërhyrjet dhe shërbimet e parashikuara në të sipas afateve kohore, në lidhje me fëmijën dhe sipas rastit, familjen biologjike/aktuale.
3. PIM përfshin masa konkrete për fuqizimin e familjes biologjike/aktuale, përmirësimin e kapaciteteve prindërore, ruajtjen e marrëdhënieve familjare dhe përgatitjen për riintegrimin e fëmijës në familje, kur kjo është e mundur dhe në interesin më të lartë të fëmijës.
4. PMF-ja monitoron periodikisht progresin e familjes biologjike/aktuale në zbatimin e masave të përcaktuara në PIM dhe dokumenton ecurinë e tyre në funksion të vlerësimit të mundësisë së riintegrit të fëmijës.
5. Fëmija informohet në mënyrë të përshtatshme për moshën dhe nivelin e tij/saj të zhvillimit mbi përmbajtjen e Planit Individual të Mbrojtjes, masat e propozuara dhe shërbimet e planifikuara. Mendimi dhe, sipas rastit, pëlqimi i fëmijës dokumentohen si pjesë e procesit të hartimit dhe rishikimit të PIM-it.
6. PIM zbatohet në përputhje me përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e fëmijës dhe është dokument themelor mbi të cilin ndërtohet Plani Individual i Kujdesit Alternativ.

### **Neni 13**

#### **Hartimi dhe rishikimi i Planit Individual të Kujdesit (PIK)**

1. Pas vendimit të gjykatës për konfirmimin e vlefshmërisë së masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje, PMF-ja përditëson Planin Individual të Mbrojtjes dhe harton Planin Individual të Kujdesit (PIK), sipas formularit standard bashkëlidhur këtij vendimi si Shtojca nr. 1.
2. Plani Individual i Kujdesit është dokumenti bazë i menaxhimit të rastit në kujdesin alternativ në familje dhe përcakton në mënyrë të detajuar:
  - a) objektivat për mirëqenien, zhvillimin dhe stabilitetin e fëmijës;
  - b) shërbimet dhe ndërhyrjet për fëmijën dhe familjen kujdestare;
  - c) masat për ruajtjen dhe, kur është e mundur, forcimin e lidhjeve me familjen biologjike;
  - ç) afatet, përgjegjësit dhe treguesit e realizimit.
3. PIK hartohet dhe zbatohet nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, në bashkëpunim me NJVNR-në dhe/ose ofruesit e shërbimeve komunitare/shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen, familjen kujdestare dhe aktorët e tjerë të përfshirë.
4. PIK monitorohet dhe rishqyrtohet periodikisht sipas të njëjtave afate dhe procedura si PIM-i, në përputhje me standardet e shërbimit të kujdesit alternativ në familje.
5. Monitorimi i PIK realizohet edhe nëpërmjet:
  - a) vizitave në familjen kujdestare;
  - b) intervistave me fëmijën dhe familjen kujdestare;

- c) konsultimeve me institucionet dhe shërbimet përkatëse.
- 6. Çdo rishqyrtim i PIK dokumentohet dhe pasqyrohet në planin e përditësuar, duke garantuar vijimësinë dhe cilësinë e kujdesit në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.
- 7. Plani i rishikuar i paraqitet drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki dhe miratohet brenda dy (2) ditëve pune nga data e paraqitjes.

## Neni 16

### **Vlerësimi periodik i situatës së fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje**

1. Fëmija i vendosur në kujdes alternativ në familje i nënshtrohet vlerësimit periodik të detyrueshëm, i cili synon të verifikojë në mënyrë të vazhdueshme nëse masa e kujdesit alternativ mbetet në interesin më të lartë të fëmijës, nëse kushtet e ofrimit të kujdesit janë të përshtatshme dhe nëse Plani Individual i Kujdesit po zbatohet në mënyrë efektive.
2. Vlerësimi periodik është pjesë e procesit të menaxhimit të rastit dhe realizohet gjatë gjithë periudhës së vendosjes së fëmijës në kujdes alternativ në familje, deri në përfundimin e masës, riintegrimin, ribashkimin, birësimin ose kalimin në një formë tjetër të kujdesit alternativ.
3. Vlerësimi periodik kryhet nga njësia/punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, në cilësinë e menaxherit të rastit, në bashkëpunim me njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit në nivel vendor dhe me ekipin shumëdisiplinar të shërbimeve komunitare. Në proces përfshihen, sipas rastit, strukturat arsimore, shëndetësore, shërbimet psikosociale dhe ofrues të tjerë të shërbimeve të parashikuara në Planin Individual të Mbrojtjes dhe/ose Kujdesit.
4. Vlerësimi periodik për zbatimin e PIK realizohet çdo 2 (dy) javë në 3 muajt e parë për familjen dhe fëmijën e vendosur në kujdestari dhe më pas, çdo muaj, ose në çdo kohë, në mënyrë të jashtëzakonshme, kur evidentohen rrethana që mund të çënojnë sigurinë, zhvillimin ose mirëqenien e fëmijës. Rezultatet e çdo vizite dokumentohen dhe përfshihen në dosjen përkatëse të fëmijës.
5. Vlerësimi periodik përfshin analizën e plotë të situatës së fëmijës, lidhur me:
  - a) gjendjen fizike dhe shëndetësore, përfshirë aksesin në shërbimet mjekësore;
  - b) gjendjen psikologjike, emocionale dhe sjellore;
  - c) zhvillimin arsimor, frekuentimin e rregullt të shkollës dhe përfshirjen në aktivitete sociale;
  - d) cilësinë e marrëdhënies dhe lidhjes emocionale me familjen kujdestare;
  - e) marrëdhëniet me familjen biologjike/aktuale dhe realizimin e kontakteve;
  - f) respektimin e të drejtave të fëmijës, përfshirë të drejtën për pjesëmarrje dhe informim;
  - g) nivelin e përmbushjes së objektivave të Planit Individual të Kujdesit;
 vlerësimin e vazhdimësisë ose nevojës për ndryshim të masës së kujdesit alternativ.
6. Vlerësimi periodik realizohet në përputhje me formatet e përcaktuara në Shtojcën nr. 2, Formulari për vlerësimin periodik në familjen kujdestare, Shtojcën nr. 3, Formulari i intervistës me fëmijën e vendosur në kujdes alternativ në familje, Shtojcën nr. 4, Formulari

- i intervistës me familjen kujdestare/biologjike, Shtojcën nr. 5, Matrica e analizës së riskut (me familjen kujdestare/biologjike), bashkëlidhur këtij vendimi.
7. Gjatë procesit të vlerësimit periodik:
    - a) sigurohet dëgjimi i fëmijës në mënyrë individuale, në mjedis të përshtatshëm dhe të sigurt dhe konfidenciale pa praninë e familjes kujdestare, duke përdorur metoda të komunikimit të përshtatura sipas moshës, nivelit të zhvillimit dhe, në rastin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, sipas nevojave të tyre specifike;
    - b) kryhet vizitë në familjen kujdestare;
    - c) zhvillohen takime me familjen kujdestare dhe, me familjen biologjike/aktuale;
    - d) mbledhen informacione nga institucionet dhe shërbimet e përfshira në Planin Individual;
    - e) vlerësohet interesimi/atahimi i marrëdhënieve të fëmijës dhe prindërve biologjik;
    - f) vlerësohen faktorët e rrezikut dhe faktorët mbrojtës që ndikojnë në situatën e fëmijës.
  8. Rezultatet e vlerësimit formalizohen në një raport të arsyetuar me shkrim, i cili përmban analizën e situatës aktuale, konstatimet mbi zbatimin e Planit Individual dhe rekomandimet për vijimësinë e masës. Raporti mund të rekomandojë:
    - a) vazhdimin e kujdesit alternativ në familje;
    - b) rishikimin ose përditësimin e Planit Individual;
    - c) ndryshimin e familjes kujdestare;
    - d) përgatitjen për riintegrim në familjen biologjike/aktuale;Eereferimin për birësim ose zgjidhje tjetër të përhershme;
    - d) ndërprerjen e menjëhershme të vendosjes, kur konstatohet rrezik serioz për fëmijën.
  9. Raporti i vlerësimit periodik, i hartuar sipas Shtojcës nr. 6, Struktura e raportit të vlerësimit periodik, bashkëlidhur këtij vendimi, i paraqitet Komisionit Multidisiplinar dhe strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki për shqyrtim dhe marrje vendimi, kur rekomandohen ndryshime në masën e kujdesit alternativ.
  10. Në rast se nga vlerësimi periodik rezulton se masa e kujdesit alternativ nuk është më në interesin më të lartë të fëmijës, njësia/punonjësi i mbrojtjes së fëmijës ndërmerr menjëherë procedurat përkatëse administrative dhe kur kërkohet nga legjislacioni në fuqi, paraqet kërkesën në gjykatë për rishqyrtim të masës së mbrojtjes, përfshirë zëvendësimin e kujdestarisë familjare ose ndryshimin e formës së kujdesit alternativ.
  11. Të gjitha raportet dhe dokumentacioni i vlerësimit periodik regjistrohen në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje dhe ruhen në dosjen e menaxhimit të rastit, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
  12. Shërbimi Social Shtetëror dhe strukturat e tij rajonale monitorojnë zbatimin e detyrimit për vlerësim periodik, në kuadër të funksionit të tyre mbikëqyrës dhe metodologjik.

## Neni 17

### Riintegrimi i fëmijës në familjen biologjike/aktuale

1. Kur nga vlerësimi periodik i situatës së fëmijës dhe raporti i vlerësimit rezulton se familja biologjike/aktuale ka rikthyer kapacitetet e nevojshme për përkujdesje dhe se riintegrimi

është në interesin më të lartë të fëmijës, Komisioni Multidisiplinar shqyrton rastin dhe rekomandon riintegrimin e fëmijës në familjen biologjike/aktuale. Në këto raste, njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ndjek procedurat për paraqitjen në gjykatë të kërkesës për rishikimin ose heqjen e masës së mbrojtjes dhe përfundimin e kujdestarisë familjare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Procesi i riintegrit realizohet në mënyrë të planifikuar, të monitoruar dhe të mbështetur, nëpërmjet:
  - a) hartimit ose rishikimit të planit individual të kujdesit dhe planit të riintegrit;
  - b) përgatitjes psiko-sociale të fëmijës dhe familjes biologjike/aktuale;
  - c) kontakteve dhe takimeve graduale ndërmjet fëmijës dhe familjes biologjike/aktuale;
  - ç) ofrimit të shërbimeve mbështetëse për familjen biologjike/aktuale;
  - d) monitorimit të vazhdueshëm pas kthimit të fëmijës në familje.
3. Riintegrimi i fëmijës në familjen biologjike/aktuale realizohet vetëm pas vlerësimit se janë eliminuar ose reduktuar rreziqet që çuan në vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje.
4. Në rast se gjatë procesit të riintegrit konstatohet se kthimi i fëmijës çënon sigurinë, mirëqenien ose interesin më të lartë të tij/saj, strukturat përgjegjëse ndërmarrin menjëherë masa për rishikimin e situatës dhe vijimësinë e mbrojtjes së fëmijës.
5. Procedurat dhe standardet për riintegrimin e fëmijës në familjen biologjike/aktuale përcaktohen në planin individual të kujdesit dhe aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

## **Neni 18**

### **Dokumentimi dhe dosja e rastit**

1. Dokumentimi i rastit kryhet nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, i cili, kur nga vlerësimi rezulton se fëmija është në nevojë për mbrojtje dhe/ose i propozohet apo vendoset në kujdes alternativ në familje, hap dhe administron dosjen individuale të fëmijës, duke i caktuar një numër identifikues që përdoret gjatë gjithë procesit të menaxhimit të rastit dhe në komunikimet përkatëse. Dosja mbahet në format letre dhe elektronik dhe përmban formularët standardë të këtij vendimi, raportimet, vlerësimet, Planin Individual PIM/PIK dhe rishikimet e tij, procesverbalet e mbledhjeve të ekipit shumëdisiplinar të qendrave komunitare, korrespondencën zyrtare, si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm për ndjekjen e rastit. Në rast se pas vlerësimit fillestar rezulton se fëmija nuk është në nevojë për mbrojtje, nuk hapet dosje individuale, por veprimet e kryera evidentohen në regjistrin përkatës.
2. Dosja në letër (hardcopy) përmban dokumentacionin origjinal dhe ruhet në kushte sigurie, ndërsa dosja elektronike përditësohet në mënyrë të rregullt me të dhënat dhe dokumentet përkatëse. Përpunimi, ruajtja dhe shkëmbimi i të dhënave personale kryhen vetëm nga personat e autorizuar dhe vetëm për qëllime të ligjshme, duke garantuar konfidencialitetin dhe aksesin e kufizuar. Dosja arkivohet sipas rregullave në fuqi dhe në rast transferimi të

- rastit, përcillet dokumentacioni i nevojshëm pranë strukturës pritëse, duke garantuar vijimësinë e menaxhimit të rastit dhe përditësimin e regjistrave.
3. Dosja përmban dokumentacionin e mëposhtëm, sipas formularëve bashkëlidhur këtij vendimi, i cili mund të pasurohet me informacion shtesë në varësi të trajtimit dhe ndjekjes së rastit:
    - a) Shtojca nr. 1 – Formulari i Planit Individual të Kujdesit
    - b) Shtojca nr. 2 – Formulari për vlerësimin periodik në familjen kujdestare
    - c) Shtojca nr. 3 - Formulari i intervistës me fëmijën e vendosur në kujdes alternativ në familje
    - d) Shtojca nr. 4 - Formulari i intervistës me familjen kujdestare/biologjike
    - e) Shtojca nr. 5 - Matrica e analizës së riskut (me familjen kujdestare/biologjike)
    - f) Shtojca nr. 6 – Struktura e raportit të vlerësimit periodik.
  4. Rastet dhe dokumentacioni për çdo fëmijë të ndjekur deri në vendimin përfundimtar dhe zgjidhjen e alternativës për vendosje në familje kujdestare regjistrohen në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje.

## **Neni 19**

### **Transferimi dhe mbyllja e rastit**

1. Transferimi i rastit kryhet kur:
  - a) gjatë zbatimit të masës së mbrojtjes dhe/ose kujdesit alternativ në familje, ndryshon vendbanimi ose vendqëndrimi i fëmijës dhe përgjegjësia për menaxhimin e rastit kalon në një njësi tjetër vendore. Në këto raste, transferimi realizohet nëpërmjet referimit administrativ ndërmjet strukturave përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës dhe shërbimet shoqërore;
  - b) kur fëmija zhvendoset në një familje tjetër kujdestare. Ndryshimi i familjes kujdestare ose i formës së kujdesit alternativ realizohet vetëm pas vlerësimit të situatës së fëmijës, shqyrtimit nga Komisioni Multidisiplinar dhe vendimmarrjes së gjykatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
  - c) si dhe në çdo rast tjetër kur, për arsye të garantimit të vazhdimësisë së mbrojtjes, kërkohet ndryshimi i strukturës përgjegjëse për ndjekjen e rastit;
  - d) vendimmarrja të jetë miratuar në gjykatë.
2. Transferimi shoqërohet me përcjelljen e dosjes së plotë dhe dokumentacionit shoqëruar, përfshirë Planin Individual dhe rishikimet e tij, raportet e vlerësimit/monitorimit dhe çdo vendimmarrje të ndërmarrë, duke garantuar që struktura pritëse të marrë në përgjegjësi rastin pa ndërprerje të shërbimeve dhe të vijojë zbatimin e Planit Individual ose ta rishikojë atë sipas nevojës.
3. Struktura referuese dokumenton aktin e transferimit dhe përditëson regjistrat përkatës, ndërsa struktura pritëse konfirmon marrjen e dosjes dhe cakton menaxherin e rastit, duke siguruar kontaktin e parë me fëmijën dhe familjen kujdestare brenda afatit të përcaktuar nga ky vendim.

4. Rasti mbyllet kur, pas rishqyrtimit të Planit Individual PIM/PIK dhe vlerësimit të situatës, konstatohet se:
  - a) përfundon masa e mbrojtjes dhe/ose përfundon afati i vendosjes së fëmijës në kujdes alternativ në familje, sipas vendimit përkatës.
  - b) fëmija rikthehet në familjen biologjike/aktuale dhe vlerësohet se rikthimi është i sigurt e i qëndrueshëm, ose kur vendoset një zgjidhje tjetër e qëndrueshme e përshtatshme për interesin më të lartë të fëmijës.
  - c) fëmija mbush moshën 18 vjeç; kur ka nevoja të mëtjshme për mbështetje, kryhet referimi pranë shërbimeve përkatëse për të rritur, me qëllim vijimësinë e mbështetjes.
  - d) fëmija birësohet nga familja kujdestare ose familje tjetër birësuese.
  - e) fëmija humb jetën.
5. Mbyllja e rastit propozohet nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, dokumentohet në formularin përkatës, pasqyrohet në dosjen e fëmijës dhe miratohet nga drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki, komisioni multidisiplinar për kujdesin alternativ dhe gjykata; në rast transferimi, rasti konsiderohet i mbyllur nga struktura referuese vetëm pasi të jetë konfirmuar marrja e dosjes dhe kalimi i përgjegjësisë pranë strukturës pritëse.
6. Vendimi/dokumentacioni i mbylljes së rastit hidhet në regjistrin elektronik të kujdestarisë.

#### **KREU IV**

#### **BASHKËPUNIMI DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT**

##### **Neni 20**

##### **Bashkëpunimi ndërinstitucional**

1. Bashkëpunimi ndërinstitucional për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje realizohet në mënyrë të detyrueshme, të koordinuar dhe të vazhdueshme ndërmjet strukturave përgjegjëse në nivel vendor dhe qendror, institucioneve publike dhe private, si dhe ofruesve të shërbimeve, me qëllim garantimin e sigurisë, mirëqenies dhe mbrojtjes së vazhdueshme të fëmijës dhe stabilitetit të vendosjes në familjen kujdestare. Institucionet e përfshira bashkërendojnë veprimet e tyre gjatë gjithë periudhës së kujdesit alternativ, përfshirë fazën e përgatitjes së fëmijës për vendosje, përshtatjen në familjen kujdestare, monitorimin e situatës dhe zbatimin e Planit Individual, si dhe planifikimin e zgjidhjes së qëndrueshme për fëmijën.
2. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, në cilësinë e menaxherit të rastit, bashkërendon ndërveprimin ndërinstitucional dhe siguron funksionimin e ekipit shumëdisiplinar/GTN për shqyrtimin e vlerësimeve, ndarjen e detyrave, përcaktimin e afateve dhe rishikimin e Planit Individual. Çdo institucion, autoritet ose ofrues shërbimi i përfshirë në Planin Individual është i detyruar të zbatojë detyrimet që i ngarkohen, të raportojë mbi realizimin e tyre dhe të ofrojë mbështetjen e nevojshme për fëmijën, familjen kujdestare dhe, sipas rastit, familjen biologjike/aktuale, duke respektuar konfidencialitetin dhe legjislacionin për

mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve kryhet vetëm për qëllime të mbrojtjes së fëmijës dhe zbatimit të Planit Individual, në masën e nevojshme dhe nga personat e autorizuar, duke u dokumentuar në dosjen e rastit. Institucionet e përfshira sigurojnë përgjigje dhe veprim brenda afateve të përcaktuara në Planin Individual dhe marrin pjesë në mbledhjet e thirrura nga menaxheri i rastit.
4. Në rastet kur menaxhimi i rastit kërkon veprim në më shumë se një njësi vendore, bashkitë bashkëpunojnë për vijimin e shërbimeve, transferimin e dokumentacionit dhe monitorimin e situatës, duke garantuar që fëmija të mos mbetet pa mbështetje gjatë lëvizjes ose ndryshimit të vendbanimit.
5. Në rastet kur një fëmijë me vendbanim në një bashki vendoset në kujdes alternativ në familje kujdestare që i përket listës së një bashkie tjetër:
  - a) bashkia ku ka vendbanimin fëmija mban përgjegjësinë për menaxhimin e rastit, hartimin dhe rishikimin e Planit Individual, si dhe për ndjekjen e procedurave ligjore;
  - b) bashkia ku ndodhet familja kujdestare është përgjegjëse për mbështetjen, monitorimin e përditshëm të vendosjes dhe bashkëpunimin me menaxherin e rastit;
  - c) vendimmarrja për vendosjen në kujdes alternativ realizohet nga strukturat përgjegjëse të bashkisë së origjinës së fëmijës, në bashkëpunim me bashkinë pritëse.
6. Në rastet kur një fëmijë me vendbanim në një bashki vendoset në kujdes alternativ pranë një familjeje kujdestare të regjistruar në një bashki tjetër, bashkitë përkatëse bashkëpunojnë për garantimin e vazhdimësisë së mbrojtjes, monitorimit dhe ofrimit të shërbimeve për fëmijën dhe familjen kujdestare. Komisioni Multidisiplinar i bashkisë ku ka vendbanimin fëmija shqyrton rastin dhe vendos për përshtatshmërinë e vendosjes së fëmijës në familjen kujdestare, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të bashkisë pritëse.

Bashkia ku ka vendbanimin fëmija:

  - a) mban përgjegjësinë për menaxhimin e rastit, hartimin dhe rishikimin e PIM/PIK;
  - b) ndjek procedurat për paraqitjen e kërkesave në gjykatë;
  - c) koordinon procesin e monitorimit dhe vlerësimit periodik të rastit.

Bashkia ku ndodhet familja kujdestare:

  - a) mbështet monitorimin e përditshëm të vendosjes;
  - b) kryen vizita dhe ndjek situatën e fëmijës dhe familjes kujdestare;
  - c) i përcjell periodikisht informacion dhe raportime menaxherit të rastit dhe bashkisë së origjinës së fëmijës.

Bashkëpunimi ndërmjet bashkive realizohet nëpërmjet shkëmbimit periodik të informacionit, raportimeve të dokumentuara, mbledhjeve koordinuese dhe komunikimit ndërinstytucional ndërmjet strukturave përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës dhe kujdesin alternativ.

Shërbimi Social Shtetëror dhe strukturat e tij rajonale mbështesin dhe koordinojnë bashkëpunimin ndërmjet bashkive në rastet e vendosjeve ndërvendore.
7. Në raste të veçanta, kur vlerësohet se qëndrimi i fëmijës në të njëjtën zonë gjeografike përbën rrezik për sigurinë e tij/saj, përfshirë rastet e abuzimit të rëndë ose rrezikshmërisë

nga familja biologjike, mund të vendoset zhvendosja e fëmijës në një bashki tjetër, duke garantuar konfidencialitetin e vendndodhjes së tij/saj. Kjo masë ndërmerret në bazë të vlerësimit profesional të strukturave përgjegjëse dhe miratohet nga gjykata, në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe legjislacionin në fuqi.

## **Neni 21**

### **Konfidencialitetit dhe mbrojtja e të dhënave personale**

1. Të gjitha informacionet dhe të dhënat personale që lidhen me fëmijën, familjen biologjike/aktuale dhe familjen kujdestare trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe me parimin e konfidencialitetit.
2. Akses në të dhënat dhe dokumentacionin e rastit kanë vetëm personat e autorizuar që janë të përfshirë në procesin e menaxhimit të rastit, sipas kompetencave të tyre institucionale.
3. Përpunimi i të dhënave personale bëhet vetëm për qëllime të mbrojtjes së fëmijës, menaxhimit të rastit dhe zbatimit të Planit Individual.
4. Informacioni për fëmijën nuk publikohet dhe nuk shpërndalet për qëllime të tjera, përveç rasteve kur:
  - a) kërkohet nga organet e drejtësisë;
  - b) kërkohet nga autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës;
  - c) është e nevojshme për garantimin e sigurisë dhe interesit më të lartë të fëmijës.
5. Institucionet përgjegjëse marrin masa teknike dhe organizative për ruajtjen e sigurt të dokumentacionit dhe të dhënave elektronike.

## **Neni 22**

### **Rregulla për shkëmbimin e të dhënave dhe autorizimet**

1. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve të përfshira në menaxhimin e rastit kryhet vetëm në masën e nevojshme për realizimin e detyrave të tyre.
2. Shkëmbimi i të dhënave kryhet:
  - a) në formë shkresore;
  - b) nëpërmjet sistemeve elektronike të autorizuara;
  - c) nëpërmjet Regjistrit Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje.
3. Çdo shkëmbim informacioni dokumentohet në dosjen e rastit dhe duhet të përmbajë:
  - a) institucionin që kërkon informacionin;
  - b) qëllimin e përdorimit;
  - c) datën dhe mënyrën e transmetimit.
4. Institucionet e përfshira duhet të sigurojnë gjurmueshmërinë e përdorimit të të dhënave dhe përgjegjësinë për çdo përdorim të paautorizuar.
5. Autoritetet përgjegjëse, sipas nevojës, udhëzojnë strukturat e brendshme të tyre për mënyrën e administrimit dhe shkëmbimit të të dhënave.

**Neni 23**  
**Monitorimi dhe raportimi**

1. Strukturat përgjegjëse për zbatimin dhe ato përgjegjëse për monitorimin e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje sipas ligjit për kujdesin alternativ në familje në fuqi monitorojnë zbatimin e këtij vendimi në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi për monitorimin.
2. Bashkitë raportojnë për zbatimin e këtij vendimi sipas Shtojcës nr. 7, Formati standard i raportimit statistikor për kujdesin alternativ në familje, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Shërbimi Social Shtetëror në nivel qendror dhe rajonal monitoron zbatimin e këtij vendimi në nivel kombëtar dhe siguron mbledhjen, përpunimin, analizimin, raportimin e të dhënave të dërguara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe publikimin periodik të të dhënave të agreguara, për qëllime transparence, monitorimi dhe politikëbërjeje.

## Shtojca nr. 1 – Formulari i planit individual të kujdesit (PIK)

### Formulari i Planit Individual të Kujdesit Alternativ në Familje (PIK)

Nr. i Regjistrimit (Kodi): \_\_\_\_\_

Data e miratimit të Planit Individual të Kujdesit: \_\_\_\_\_

Data e rishikimit të Planit Individual të Kujdesit: \_\_\_\_\_

Lloji i kujdesit alternativ në familje:

- Kujdes alternativ profesional emergjent
- Kujdes alternativ profesional i specializuar
- Kujdes alternativ vullnetar nga të afërm
- Kujdes alternativ vullnetar jo nga të afërm

Data e vendosjes së fëmijës në familjen kujdestare: \_\_\_\_\_

Emri i fëmijës: \_\_\_\_\_

Emri i familjes kujdestare: \_\_\_\_\_

PMF përgjegjës për rastin: \_\_\_\_\_

Veprimet e nevojshme	Nevojat e fëmijës/familjes që adresojnë këto veprime	Personi/institucioni përgjegjës	Afati kohor	Komente mbi progresin e arritur (datat)

#### - Elemente specifike të kujdesit alternativ në familje

##### *Kontakti me familjen biologjike/aktuale*

Frekuenca e kontakteve: \_\_\_\_\_

Forma e kontakteve:

- Vizita fizike
- Telefonata
- Kontakt online
- Kontakt i mbikëqyrur (me praninë e PMF/profesionistit përgjegjës)
- Kontakt i pambikëqyrur (pa praninë e PMF/profesionistit përgjegjës)

Komente:

---

---

---

##### *Mbështetja për familjen kujdestare*

- Supervizim profesional
- Mbështetje psikologjike
- Trajnim shtesë
- Mbështetje financiare
- Mbështetje emergjente
- Tjetër: \_\_\_\_\_

**Objektivi afatgjatë i rastit**

- Riintegrim në familjen biologjike/aktuale
- Vëllim i kujdesit alternativ afatgjatë
- Birësim
- Përgatitje për jetë të pavarur
- Tjetër: \_\_\_\_\_

**Persona të përfshirë në hartimin e PIK**

Emër/Mbiemër	Funksioni	Firma
	PMF	
	NJVNR	
	Psikolog	
	Familja kujdestare	
	Prindi biologjik/aktual	
	Fëmija (sipas moshës dhe kapacitetit)	

**Personat të cilët nuk bien dakord me PIK dhe arsyet:**

---



---



---

**Rishikimi dhe miratimi nga Drejtori i Strukturës së Shërbimeve Sociale në Bashki:**

Data: \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

Firma dhe nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Shtojca nr.2 – Formulari për vlerësimin periodik në familjen kujdestare

**Formulari për vlerësimin periodik në familjen kujdestare**

**I. Të dhëna identifikuese**

Numri i rastit: \_\_\_\_\_  
Emri i fëmijës: \_\_\_\_\_  
Moshë e fëmijës: \_\_\_\_\_  
Emri i familjes kujdestare: \_\_\_\_\_  
Adresa e familjes kujdestare: \_\_\_\_\_  
Data e vizitës në terren: \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_  
Emri i profesionistit/ët që kryen/jnë vizitën: \_\_\_\_\_  
Funksioni: \_\_\_\_\_  
Persona të pranishëm gjatë vizitës: \_\_\_\_\_  
Data e vizitës së fundit në familje \_\_\_\_\_

**II. Qëllimi i vizitës**

- Monitorim periodik i situatës së fëmijës
- Vlerësim i mirëqenies së fëmijës
- Ndjekje e Planit Individual
- Verifikim i kushteve të jetesës
- Vizitë pas raportimit të një shqetësimi
- Tjetër: \_\_\_\_\_

**III. Kushtet e jetesës në familjen kujdestare**

Elementi për t'u vlerësuar	Po	Jo	Komente
Shtëpia është e sigurt dhe e përshtatshme për fëmijën			
Fëmija ka hapësirë të përshtatshme për të fjetur			
Ambienti është i pastër dhe i rregullt			
Fëmija ka akses në ushqim të mjaftueshëm			
Fëmija ka akses në veshje të përshtatshme			
Fëmija ka akses në materiale shkollore			

**Shënime të intervistuesit:**

---

---

---

#### IV. Mirëqenia e fëmijës

Elementi për t'u vlerësuar	Po	Jo	Komente
Fëmija duket në gjendje të mirë shëndetësore			
Fëmija duket emocionalisht i qëndrueshëm			
Fëmija merr kujdes të mjaftueshëm nga familja kujdestare			
Fëmija merr pjesë në aktivitete edukative/shkollë			
Fëmija merr pjesë në aktivitete sociale ose rekreative			

Shënime:

---

---

---

#### V. Marrëdhëniet në familjen kujdestare

Elementi për t'u vlerësuar	Po	Jo	Komente
Marrëdhënie pozitive mes fëmijës dhe familjes kujdestare			
Fëmija përfshihet në aktivitetet familjare			
Familja kujdestare tregon kujdes dhe mbështetje			
Nuk janë evidentuar konflikte serioze			

Shënime:

---

---

---

#### VI. Siguria dhe mbrojtja e fëmijës

Elementi për t'u vlerësuar	Po	Jo	Komente
Fëmija ndihet i sigurt në familjen kujdestare			
Nuk ka shenja dhune fizike ose emocionale			
Familja kujdestare respekton të drejtat e fëmijës			
Fëmija ka mundësi të shprehë mendimin e tij/saj			

Shënime:

---

---

---

## VII. Kontakti me familjen biologjike

Elementi për t'u vlerësuar	Po	Jo	Komente
Kontakti me familjen biologjike zhvillohet sipas planit			
Kontakti nuk ndikon negativisht në mirëqenien e fëmijës			
Familja kujdestare bashkëpunon për realizimin e kontakteve			

Shënime:

---

---

---

## VIII. Mbështetja për familjen kujdestare

Elementi për t'u vlerësuar	Po	Jo	Komente
Familja kujdestare ka nevojë për mbështetje profesionale			
Familja kujdestare ka nevojë për këshillim ose trajnim			
Familja kujdestare ka nevojë për mbështetje sociale ose financiare			

Shënime:

---

---

---

## IX. Përmbledhje e vizitës

Elemente pozitive të evidentuara

---

---

---

Problematika ose rreziqe të identifikuara

---

---

---

Masa ose ndërhyrje të rekomanduara

---

---

---

Veprimet që duhen ndërmarrë

---

---

---

**X. Konfirmimi**

Vizita në terren u krye dhe informacioni u dokumentua në përputhje me procedurat e menaxhimit të rastit.

**Emri dhe mbiemri i profesionistit/ëve:** \_\_\_\_\_

**Nënshkrimi:** \_\_\_\_\_

**Data:** \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

**Shtojca nr. 3 - Formulari i intervistës me fëmijën së vendosur në kujdes alternativ në familje**

**Formulari i intervistës me fëmijën e vendosur në kujdes alternativ në familje**

*(për vlerësimin periodik të situatës së fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje)*

**I. Të dhëna identifikuese**

Numri i rastit: \_\_\_\_\_

Emri i fëmijës: \_\_\_\_\_

Mosha: \_\_\_\_\_

Gjinia: \_\_\_\_\_

Data e intervistës: \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

Vendi i intervistës: \_\_\_\_\_

Emri i intervistuesit: \_\_\_\_\_

Funksioni: \_\_\_\_\_

Persona të pranishëm gjatë intervistës (nëse ka): \_\_\_\_\_

Intervista u zhvillua individualisht me fëmijën, pa praninë e prindit/familjes kujdestare ose personave të tjerë.

Intervista u zhvillua në praninë e: \_\_\_\_\_

**II. Udhëzime për plotësimin**

Ky formular plotësohet nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës/menaxheri i rastit ose profesionisti i autorizuar, në mjedis të sigurt dhe miqësor për fëmijën, duke marrë parasysh moshën, pjekurinë dhe gjendjen emocionale të tij/saj.

Pyetjet bëhen në mënyrë të kuptueshme, pa ushtruar presion, dhe përgjigjet dokumentohen sa më besnikërisht.

**III. Pyetje për intervistën**

**A. Mirëqenia e përgjithshme**

- Si je ndjerë kohët e fundit?
- Si shkon një ditë e zakonshme për ty në familjen ku jeton tani?
- A ndihesh mirë fizikisht? Ke pasur ndonjë shqetësim me shëndetin?
- A fle mirë? A ushqehesh rregullisht?
- A ka gjëra që të bëjnë të ndihesh i/e trishtuar, i/e shqetësuar ose i/e frikësuar?
- Çfarë të pëlqen më shumë në jetën tënde të përditshme tani?
- Çfarë do të doje të ndryshonte që të ndiheshe më mirë?

Shënime të intervistuesit:

---

---

---

### **B. Marrëdhëniet me familjen kujdestare**

- Si shkon me familjen kujdestare?
- Me kë nga familja kujdestare ndihesh më afër?
- A të dëgjojnë kur do të flasësh ose të tregosh diçka?
- A ndihesh i/e respektuar nga anëtarët e familjes kujdestare?
- Kur ke një problem, kujt i drejtohesh në familjen kujdestare?
- A ka pasur ndonjë sjellje nga ndonjë anëtar i familjes kujdestare që të ka mërziur ose lënduar?
- A ndihesh i/e përfshirë në aktivitetet e familjes?

Shënime të intervistuesit:

---

---

---

### **C. Ndjenja e sigurisë**

- A ndihesh i/e sigurt në shtëpinë ku jeton tani?
- A ka ndodhur ndonjëherë që të jesh ndjerë i/e frikësuar në familjen kujdestare?
- A ka dikush që të ka bërtitur, kërcënuar, goditur ose të ka bërë të ndihesh keq?
- Nëse ndihesh i/e pasigurt ose i/e mërziur, a di kujt t'i tregosh?
- A ndihesh i/e sigurt edhe në shkollë dhe në ambientet ku kalon kohën?
- A mendon se dikush kujdeset për ty dhe të mbron kur ke nevojë?

Shënime të intervistuesit:

---

---

---

### **D. Marrëdhëniet me familjen biologjike/aktuale**

- A ke kontakte me familjen tënde biologjike/aktuale?
- Si ndihesh kur flet ose takohesh me ta?
- A do të doje t'i takoje më shpesh, më rrallë, apo kështu siç është tani?
- A ka ndonjë person nga familja jote biologjike/aktuale me të cilin dëshiron të kesh më shumë kontakt?
- A ka ndonjë kontakt që të bën të ndihesh i/e mërziur, i/e pasigurt ose i/e shqetësuar?
- A të mungon familja jote biologjike/aktuale? Në çfarë mënyre?

Shënime të intervistuesit:

---

---

---

### **E. Opinioni për vendosjen aktuale**

- Si ndihesh për faktin që jeton në këtë familje kujdestare?
- Çfarë të pëlqen më shumë nga kjo vendosje?
- Çfarë nuk të pëlqen ose çfarë të shqetëson?
- A do të doje të vazhdoje të jetosh këtu?
- A mendon se kjo familje është vendi i duhur për ty tani?
- A ke ndonjë dëshirë ose mendim se çfarë duhet të ndodhë më tej për ty?
- Çfarë do të doje që të rriturit të dinin për mënyrën si ndihesh?

Shënime të intervistuesit:

---

---

---

### **IV. Vlerësimi përmbljedhës i intervistuesit**

1. Gjendja emocionale e fëmijës gjatë intervistës

---

---

---

2. Elemente pozitive të evidentuara

---

---

---

3. Shqetësime/rreziqe të evidentuara

---

---

---

4. Nevoja të identifikuar për mbështetje

---

---

---

5. Rekomandime për Planin Individual / vlerësimin periodik

---

---

---

### **V. Konfirmimi**

Intervista u zhvillua në mënyrë të përshtatshme për moshën dhe mirëkuptimin e fëmijës:

Po

Jo

Fëmija u informua për qëllimin e intervistës:

Po

Jo

Mendimi i fëmijës u mor dhe u dokumentua:

Po

Jo

**Emri dhe mbiemri i intervistuesit:** \_\_\_\_\_

**Nënshkrimi:** \_\_\_\_\_

**Data:** \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

Shtojca nr. 4 - Formulari i intervistës me familjen kujdestare/biologjike

**Formulari i intervistës me familjen kujdestare/biologjike**  
(për vlerësimin periodik të situatës së fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje)

**I. Të dhëna identifikuese**

Numri i rastit: \_\_\_\_\_  
Emri i fëmijës: \_\_\_\_\_  
Moshë e fëmijës: \_\_\_\_\_  
Emri i familjes kujdestare: \_\_\_\_\_  
Data e intervistës: \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_  
Vendi i intervistës: \_\_\_\_\_  
Emri i intervistuesit: \_\_\_\_\_  
Funksioni: \_\_\_\_\_  
Persona të pranishëm gjatë intervistës: \_\_\_\_\_

**II. Udhëzime për plotësimin**

Ky formular plotësohet nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës/menaxheri i rastit ose profesionisti i autorizuar gjatë intervistës me familjen kujdestare.

Intervista duhet të zhvillohet në një mjedis të përshtatshëm, duke inkurajuar komunikim të hapur dhe të sqartë, me qëllim vlerësimin e situatës së fëmijës dhe mbështetjes së nevojshme për familjen kujdestare.

**III. Pyetje për intervistën**

**A. Mirëqenia dhe zhvillimi i fëmijës**

- Si e vlerësoni gjendjen e përgjithshme të fëmijës (fizike dhe emocionale)?
- Si është përshtatur fëmija me familjen dhe mjedisin tuaj?
- Si është sjellja e fëmijës në jetën e përditshme?
- A ka pasur ndryshime në gjendjen emocionale apo sjelljen e fëmijës kohët e fundit?
- Si po ecën fëmija në shkollë ose në aktivitetet edukative?
- A ka nevoja të veçanta shëndetësore, psikologjike apo sociale?
- Çfarë aktivitetesh i pëlqejnë më shumë fëmijës?

Shënime të intervistuesit:

---

---

**B. Marrëdhëniet brenda familjes kujdestare**

- Si është marrëdhënia e fëmijës me anëtarët e familjes tuaj?
- Si e përfshini fëmijën në aktivitetet familjare?

- A ka krijuar fëmija lidhje emocionale me ndonjë anëtar të familjes?
- A ka pasur situata konflikti mes fëmijës dhe anëtarëve të familjes?
- Si i zgjidhni zakonisht situatat e vështira ose konfliktet?
- Si e përjetojnë anëtarët e tjerë të familjes praninë e fëmijës në familje?

Shënime të intervistuesit:

---



---

### ***C. Ndjenja e sigurisë dhe mbrojtjes së fëmijës***

- Si siguroheni që fëmija të ndihet i sigurt dhe i mbrojtur në familjen tuaj?
- A ka pasur ndonjë situatë që ka krijuar shqetësim për sigurinë e fëmijës?
- Si reagoni kur fëmija është i mërzitur, i frikësuar ose i shqetësuar?
- Si komunikoni me fëmijën për ndjenjat dhe shqetësimet e tij/saj?
- A mendoni se fëmija ndihet i sigurt dhe i mbështetur në familjen tuaj?

Shënime të intervistuesit:

---



---

### ***D. Marrëdhëniet e fëmijës me familjen biologjike***

- A ka kontakte fëmija me familjen biologjike/aktuale?
- Si i përjeton fëmija këto kontakte?
- Si e mbështesni fëmijën gjatë ose pas këtyre kontakteve?
- A mendoni se kontaktet me familjen biologjike ndikojnë në mirëqenien e fëmijës?
- A keni vështirësi në menaxhimin e këtyre kontakteve?

Shënime të intervistuesit:

---



---

### ***E. Opinioni i familjes kujdestare për vendosjen aktuale***

- Si e vlerësoni përvojën tuaj si familje kujdestare për këtë fëmijë?
- Cilat janë aspektet më pozitive të vendosjes së fëmijës në familjen tuaj?
- Cilat janë sfidat ose vështirësitë që keni hasur?
- Çfarë mbështetjeje mendoni se ju nevojitet për të vazhduar kujdesin për fëmijën?
- A mendoni se vendosja aktuale është në interesin më të mirë të fëmijës?
- A keni rekomandime për përmirësimin e situatës së fëmijës?

Shënime të intervistuesit:

---



---

## **IV. Vlerësimi përmbljedhës i intervistuesit**

1. Vlerësimi i përgjithshëm i situatës së fëmijës në familjen kujdestare

---

---

2. Elementet pozitive të identifikuara

---

---

3. Problematika ose rreziqe të evidentuara

---

---

4. Nevoja për mbështetje për familjen kujdestare

---

---

5. Rekomandime për vijimësinë e masës dhe Planin Individual

---

---

#### **V. Konfirmimi**

Intervista u zhvillua në mënyrë të hapur dhe bashkëpunuese:

Po

Jo

Familja kujdestare u informua për qëllimin e intervistës:

Po

Jo

Informacioni i dhënë u dokumentua në mënyrë të plotë:

Po

Jo

**Emri, mbiemri i intervistuesit:** \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

## Shtojca nr. 5 - Matrica e analizës së riskut (me familjen kujdestare/biologjike)

### Matrica e analizës së riskut (me familjen kujdestare/biologjike) (për rastet e situatës së fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje)

#### I. Të dhëna identifikuese

Numri i rastit: \_\_\_\_\_

Emri i fëmijës: \_\_\_\_\_

Mosha: \_\_\_\_\_

Emri i familjes kujdestare: \_\_\_\_\_

Data e vlerësimit: \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

Emri i profesionistit që kryen vlerësimin: \_\_\_\_\_

Funksioni: \_\_\_\_\_

#### II. Qëllimi i analizës së rrezikut

Analiza e riskut përdoret për të identifikuar, vlerësuar dhe monitoruar faktorët që mund të cenojnë sigurinë, mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje.

Rezultatet e kësaj matrice përdoren për:  
përcaktimin e nivelit të rrezikut për fëmijën;  
orientimin e ndërhyrjeve në Planin Individual;  
marrjen e vendimeve për vazhdimin, ndryshimin ose ndërprerjen e vendosjes në familje kujdestare.

#### III. Shkalla e vlerësimit të rrezikut

Niveli	Përshkrimi
1	Rrezik i ulët – situata është e qëndrueshme
2	Rrezik i moderuar – kërkohet monitorim
3	Rrezik i lartë – kërkohet ndërhyrje
4	Rrezik shumë i lartë – kërkohet veprim i menjëhershëm

#### IV. Matrica e faktorëve të rrezikut

Kategoria e vlerësimit	Elementi për t'u vlerësuar	Vlerësimi (1-4)	Komente
Siguria fizike	Ekziston rrezik dhune fizike ndaj fëmijës		
	Ekziston rrezik neglizhence		
	Kushtet e jetesës janë të pasigurta		
Shëndeti fizik	Fëmija ka probleme shëndetësore të patrajtuara		

	Aksesi në shërbime shëndetësore është i kufizuar		
<b>Mirëqenia emocionale</b>	Fëmija shfaq shenja ankthi ose stresi		
	Fëmija ka vështirësi në përshtatjen me familjen kujdestare		
<b>Marrëdhëniet familjare</b>	Marrëdhënia me familjen kujdestare është konfliktuale		
	Marrëdhënia me familjen biologjike krijon stres për fëmijën		
<b>Zhvillimi arsimor dhe social</b>	Fëmija nuk ndjek rregullisht shkollën		
	Fëmija është në izolim social		
<b>Stabiliteti i vendosjes</b>	Ekziston rrezik ndërprerjeje të vendosjes		
	Familja kujdestare ka vështirësi në kujdesin për fëmijën		

#### V. Faktorët mbrojtës

Faktor mbrojtës	Po	Jo	Komente
Fëmija ka marrëdhënie të mira me familjen kujdestare	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Fëmija ndihet i sigurt në familjen kujdestare	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Fëmija ndjek rregullisht shkollën	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Fëmija ka mbështetje emocionale nga të rriturit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Fëmija ka rrjet social mbështetës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	

#### VI. Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut

Nivel i përgjithshëm i rrezikut	Përshkrimi
<input type="checkbox"/> Rrezik i ulët	Situata është e qëndrueshme
<input type="checkbox"/> Rrezik i moderuar	Kërkohet monitorim i shtuar
<input type="checkbox"/> Rrezik i lartë	Kërkohet ndërhyrje e menjëhershme
<input type="checkbox"/> Rrezik shumë i lartë	Kërkohet rishikim urgjent i vendosjes

#### VII. Rekomandimet

Bazuar në analizën e riskut rekomandohen masat e mëposhtme:

- Vazhdimi i procesit të vendosjes në familjen kujdestare
- Monitorim i shtuar i situatës së fëmijës
- Mbështetje shtesë për familjen kujdestare
- Rishikim i Planit Individual
- Ndryshim i familjes kujdestare

Fillimi i procesit të riintegrit

Masa të tjera: \_\_\_\_\_

**VIII. Përmbledhje e analizës**

---

---

---

---

**IX. Konfirmimi**

**Emri dhe mbiemri i profesionistit:** \_\_\_\_\_

**Nënshkrimi:** \_\_\_\_\_

**Data:** \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

Shtojca nr. 6 – Struktura e raportit të vlerësimit periodik

**Struktura e raportit të vlerësimit periodik**

*(për vlerësimin periodik të situatës së fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje)*

*Raport për vlerësimin periodik sipas nenit 15 të këtij vendimi*

I. Të dhëna identifikuese të rastit

Numri i rastit: \_\_\_\_\_  
Emri i fëmijës: \_\_\_\_\_  
Moshë: \_\_\_\_\_  
Data e vendosjes në kujdes alternativ: \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_  
Lloji i kujdesit alternativ:  
 Kujdes alternativ vullnetar  
 Kujdes alternativ profesional  
Emri i familjes kujdestare: \_\_\_\_\_  
Bashkia: \_\_\_\_\_

Menaxheri i rastit: \_\_\_\_\_

Data e vlerësimit periodik: \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

II. Qëllimi i vlerësimit

Ky raport përgatitet në kuadër të vlerësimit periodik të situatës së fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje dhe ka për qëllim:

- të vlerësojë mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës;
- të analizojë cilësinë e kujdesit të ofruar nga familja kujdestare;
- të verifikojë zbatimin e Planit Individual të Kujdesit;
- të identifikojë nevojat e mëtejshme për ndërhyrje ose mbështetje;
- të rekomandojë vazhdimin, ndryshimin ose ndërprerjen e masës së kujdesit alternativ.

III. Metodologjia e vlerësimit

Vlerësimi është realizuar nëpërmjet:

- Vizitës në familjen kujdestare
- Intervistës me fëmijën
- Intervistës me familjen kujdestare
- Takimit me familjen biologjike (kur është e aplikueshme)
- Konsultimit me institucionet arsimore
- Konsultimit me institucionet shëndetësore
- Analizës së dokumentacionit të dosjes së rastit

Data e vizitës në familje: \_\_\_\_\_

#### IV. Situata aktuale e fëmijës

##### 1. Gjendja fizike dhe shëndetësore

Përshkrimi i gjendjes shëndetësore të fëmijës  
Aksesi në shërbime shëndetësore  
Nevoja për trajtim ose ndjekje mjekësore

**Përshkrimi:**

---

---

##### 2. Gjendja emocionale dhe psikologjike

Përshkrimi i gjendjes emocionale në familjen kujdestare  
Shenja ankthi, stresi ose vështirësish emocionale

**Përshkrimi:**

---

---

##### 3. Zhvillimi arsimor dhe social

Frekuentimi i shkollës  
Performanca shkollore  
Marrëdhëniet me bashkëmoshatarët  
Përfshirja në aktivitete sociale ose rekreative

**Përshkrimi:**

---

---

#### V. Marrëdhëniet me familjen kujdestare

Cilësia e marrëdhënies mes fëmijës dhe familjes kujdestare  
Përshkrimi i fëmijës në familje  
Mbështetja emocionale dhe kujdesi i ofruar

**Përshkrimi:**

---

---

#### VI. Marrëdhëniet me familjen biologjike

Kontakti me familjen biologjike (nëse është i lejuar)  
Ndikimi i kontakteve në mirëqenien e fëmijës  
Perspektiva për riintegrim

**Përshkrimi:**

---

---

VII. Vlerësimi i zbatimit të Planit Individual

Elementi	Po	Jo	Komente
Objektivat e planit po realizohen			
Shërbimet e parashikuara janë ofruar			
Institucionet e përfshira kanë bashkëpunuar			
Plani kërkon rishikim			

**Analiza:**

---

---

VIII. Analiza e faktorëve të riskut dhe faktorëve mbrojtës

Faktorët e riskut

---

---

Faktorët mbrojtës

---

---

IX. Vlerësimi i përgjithshëm

Bazuar në informacionin e mbledhur dhe analizën e situatës:

- Vendosja aktuale është në interesin më të lartë të fëmijës
- Vendosja kërkon monitorim të shtuar
- Vendosja kërkon rishikim të menjëhershëm

**Analiza:**

---

---

X. Rekomandimet

Bazuar në vlerësimin periodik rekomandohet:

- Vazhdimi i kujdesit alternativ në familjen aktuale
- Rishikimi i Planit Individual
- Mbështetje shtesë për familjen kujdestare
- Ndryshimi i familjes kujdestare
- Fillimi i procesit të riintegrit në familjen biologjike
- Referimi për birësim
- Ndërprerja e menjëhershme e vendosjes

**Rekomandime të detajuara:**

---

---

**XI. Vendimmarrja institucionale**

Raporti i vlerësimit periodik i paraqitet:

- Komisionit Multidisiplinar për kujdesin alternativ
- Strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki

Vendimi:

---

---

**XII. Konfirmimi**

**Menaxheri i rastit (PMF):**

Emër dhe mbiemër: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

**Drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore:**

Emër dhe mbiemër: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

**Data:** \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

Shtojca nr. 7 - Formati standard i raportimit statistikor për kujdesin alternativ në familje

### Formati standard i raportimit statistikor për kujdesin alternativ në familje

**Tabela 1: Numri i fëmijëve në kujdes alternativ sipas karakteristikave**

Njësia vendore	Periudha raportuese	Gjithsej	Meshkuj	Femra	0-5 vjeç	6-14 vjeç	15-18 vjeç	Me aftësi të kufizuar	Lloji i kujdesit
----------------	---------------------	----------	---------	-------	----------	-----------	------------	-----------------------	------------------

**Tabela 2: Kohëzgjatja e vendosjes në kujdes alternativ**

Njësia vendore	Periudha	< 6 muaj	6-12 muaj	1-2 vite	> 2 vite	Mesatarja (muaj)
----------------	----------	----------	-----------	----------	----------	------------------

**Tabela 3: Rezultatet e rasteve (daljet nga sistemi)**

Njësia vendore	Periudha	Riintegrim	Transferim	Birësim	Arsye të tjera	Gjithsej
----------------	----------	------------	------------	---------	----------------	----------

**Tabela 4: Vlerësimet periodike dhe Planet Individuale**

Njësia vendore	Periudha	Plan Individual	Vlerësime të kryera	Të vonuara	Të papërfunduara
----------------	----------	-----------------	---------------------	------------	------------------

**Tabela 5: Transferimet dhe lëvizjet e rasteve**

Njësia vendore	Periudha	Brenda bashkisë	Ndërmjet bashkive	Raste të reja	Raste të mbyllura
----------------	----------	-----------------	-------------------	---------------	-------------------

**Tabela 6: Problematikat dhe nevojat e identifikuar**

Njësia vendore	Periudha	Numri rasteve	Lloji i problematikës	Masa të propozuara
----------------	----------	---------------	-----------------------	--------------------

#### **Udhëzime për plotësimin e tabelave:**

- Të dhënat raportohen çdo 6 muaj nga bashkitë dhe agregohen çdo vit nga Shërbimi Social Shtetëror në nivel qendror dhe rajonal.
- Të gjitha tabelat janë të detyrueshme.
- Të dhënat duhet të jenë të sakta, të ndara sipas gjinisë dhe grupmoshave, dhe në përputhje me përkufizimet standarde.
- Raportimi kryhet përmes instrumentit elektronik të miratuar.
- Respektohen rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.